


Informacion mbi takimin e organizuar nga EUROSAI IT Working Group (ITWG)

Në datë 11 dhjetor u zhvillua online takimi i radhës “virtual coffee break with a colleague” mbajtur nga EUROSAI IT Working Group, me pjesëmarrjen nga anëtarë të SAI-ve të ndryshëm, i cili u ndoq dhe nga dy auditues të Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Takimi u hap me një përmbledhje të shkurtër të aktiviteteve “virtual coffee break with a colleague” të zhvilluara më parë, i cili është i aksesueshëm vetëm për anëtarët e Grupit të Punës për IT të EUROSAI-t.

Tema e zhvilluar në këtë takim ishte “*Kontrolli i sistemit të informacionit që mbështet përgatitjen e Llogarisë Shtetërore*” nga Gjykata e Auditorëve Portugezë.



Gjatë prezantimit të temës u trajtuan informacione të ndryshme si: auditimi mbi efektivitetin operacional të kontroleve të brendshme, auditimi mbi përputhshmërinë me kërkesat e informacionit të konsolidimit dhe rregullat e vlefshmërisë, si dhe u prezantuan disa nga gjetjet kryesore.

The slide displays key findings from an audit on compliance with consolidation information requirements and validation rules. It includes a yellow warning triangle icon on the left and a robot icon on the right. The text is as follows:

AUDIT ON COMPLIANCE WITH CONSOLIDATION INFORMATION REQUIREMENTS AND VALIDATION RULES
KEY FINDINGS

Inactive Validation Rules:

- Rules BA-009 and BA-015, designed to ensure data accuracy, were not operational.
- Even if these controls were fully operational, they still **would not be sufficient** to ensure the reliability of the information necessary to the consolidation process.

Takimi u zhvillua në formë bashkëbisedimi ku çdo anëtar drejtoi pyetje nëpërmjet platformës ZOOM. Në përfundim, u diskutua mbi takimin e radhës, i cili është planifikuar të zhvillohet në muajin janar nga Sekretariati i ITWG.